

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"GF2 CONSTRUCTION" SHPK

NENI 1

Themelohet me date 01/05/2023 shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "**GF2 CONSTRUCTION**" sh.p.k, mbeshtetur ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar, ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ligjin nr. 9121, date 28.7.2003, "Per Mbrojtjen e Konkurrences", Kodin Civil dhe Kodin e Punes me ortak themelues si vijon:

Gentian Hysaj, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05/11/1975 lindur në Tirane person madhor me zotesi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar, me Nr. Personal H51105055C

Fatjon Murseli, shtetas shqiptar, i datëlindjes 26/10/1994 lindur në Shkoder dhe banues në Tirane person madhor, me zotesi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar, me Nr. Personal J41026048H.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë në Rrugen "Abdyl Frasheri", Nd. Nr.5, Hyrja 20, Ap 22, i regjistruar me nr. Pasurie 2/355+1-20, vol. 53, faqe 198, zona kadastrale 8270.
2. Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikes se Shqiperise ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne qytetin e Tiranës.
3. Vendi i mbajtjes se mbledhjeve te asamblese se pergjithshme eshte selia e shoqerise. Nese bihet dakord me unanimitet mbledhjet e asamblese mund te kryhen ne nje vend tjeter.



KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë: Hekurlidhje ne objekte banimi, vepra arti etj.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

1. Kapitali i shoqërisë ka vlerën 1000 lekë i cili përbëhet nga 2 kuota.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësise në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njejtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal që lejon ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".



KONTRIBUTET

NENI 6

Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortakët e shoqërisë, si vijon:

Ortaku **Gentian Hysaj** zotëron 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 kuotë, me vlere prej 500 lekë;

Ortaku **Fatjon Murseli** 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 kuotë, me vlere prej 500 lekë;

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 7

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe ka të drejtën e votës në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij në kapitalin që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose nje person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë (perjashtohet perfaqesimi i nje ortaku nga nje ortak tjetet apo administratori i shoqerise).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do te behet me shkrese, ose nepermjet postes elektronike.

6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nëse në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare":
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
 - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;
 - c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates);
 - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates);
 - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - l) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
11. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:



- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë se përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

14. Asambleja përgjithshme vendos me shumice të zakonshme për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave dhe vendimet merren me shumicë të gjysmës së votave të ortakëve pjesëmarrës.

15. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të kualifikuar për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo çështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve të vlefshme bëhet vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 70% e kuotave janë të pranishëm, votojnë me shkrese apo mjete elektronike. Në këto rast vendimet merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës.

16. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë pikë, të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

ADMINISTRIMI

NENI 8

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizikë të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para

mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.

3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

NENI 9

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblesën e përgjithshme përpara parashikon ky statut ose ligji.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

EMERIMI I PARE I ADMINISTRATOREVE

NENI 10

Administrator i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare emërohet ortaku **Gentian Hysaj**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05/11/1975 lindur në Tiranë, person madhor, me zotesi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar, me Nr. Personal H51105055C.

E DREJTA E VOTES

NENI 11

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

E DREJTA PER TE KALUAR REZOLUTE

NENI 12

Asambleja e përgjithshme mund të miratojë rezolute pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj. Që të miratohet një rezolute në mbledhjen e asamblese së përgjithshme duhet të jenë të pranishëm të gjithë ortakët personalisht dhe ta votojnë ato në mënyrë të unifikuar.

ZHVILLIMI I SHOQERISE

NENI 13

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, seline ligjore, objektin, mund të zmadhojë apo të zvogëlojë kapitalin themeltar, mund të pranojë ose të largojë ortakë.

MARREDHENIET E PUNES NE SHOQERI

NENI 14

Shoqëria do të përpilojë dokumentet përkatëse për punësimin e personave të tretë duke respektuar dispozitat e Kodit të Punës.



VULA E SHOQERISE

NENI 15

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme me tekstin perreth saj.

FITIMI I PERSONALITETIT JURIDIK

NENI 16

Shoqeria do te rregulloje veprimtarine e saj edhe me Statutin e saj, i cili pasi te nenshkruhet nga ortakët themelues do te fitoje personalitet juridik ne ditën e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

BILANCI DHE FITIMI

NENI 17

18. 1. Viti financiar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti.
- 18.2. Llogaritë vjetore, inventari raportet mbi operacionet e viti financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.
- 18.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

FUNKSIONIMI I SHOQERISE

NENI 18

Rregullat per funksionimin dhe drejtimin e shoqerise pervec ketij Akti Themelimi jane te percaktuara ne Statutin e Shoqerise.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

NENI 19

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shteterore, personat juridike e fizike vendas e te huaj, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas legjislacionit ne fuqi.

DISPOZITA TE TJERA


NENI 20

Ky akt themelimi perpiohet në katër kopje, duke patur secila kopje fuqi te plote ligjore.

Akti i themelimit nenskruhet rregullisht nga ortakët themelues të Shoqërisë "GF2 CONSTRUCTION" SHPK

THEMELUESIT E SHOQËRISË

GENTIAN HYSAJ

Handwritten signature of Gentian Hysaj in blue ink, consisting of a large, stylized cursive script.

FATJON MURSELI

FATJON Murseli

Handwritten signature of Fatjon Murseli in blue ink, featuring a stylized cursive script with a prominent loop.